



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 797/7 prot.

Tiranë, më 17.11.2025

V E N D I M

Nr. 51, datë 17.11.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË SË
VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË ZHVILLIMIT TË
PROCEDURËS SË REKRUTIMIT PËR PLOTËSIMIN E POZICIONIT “DREJTOR
DREJTORIE”, NË INSTITUCIONIN E INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
(INSTAT)**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit lëvizje paralele/ngritje në detyrë për plotësimin e pozicionit “Drejtor, Drejtoria e Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale”, Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, në institucionin e Institutit të Statistikave (INSTAT),

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni i dërguar shkresat me nr. 797, datë 9.9.2025; nr. 797/2 prot., datë 24.9.2025; nr.797/3 prot., datë 1.10.2025 dhe nr. 797/5 prot., datë 1.10.2025, të dërguar nga konkurrentja Ornela Fitezi, në të cilin ngrihen pretendime për parregullsi të lejuara, nga ana e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), gjatë zhvillimit të procedurës së ngritjes në detyrë për plotësimin e pozicionit të lirë “Drejtor, Drejtoria e Statistikave të Punësimit dhe

Analizave Ndërsektoriale”, Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, kodi # 248 në institucionin e Institutit të Statistikave (INSTAT).

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, rezulton se shtetësja Ornela Fitezi, është konfirmuar me statusin e nëpunësit civil, në pozicionin “*Përgjegjëse në Sektorin e Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave*”, në Drejtorinë e Statistikave të Punësimit dhe Analizave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Prodhimit Statistikor, në institucionin e Institutit të Statistikave (INSTAT).

Referuar shpalljes së publikuar nga INSTAT (në faqen Web të saj si dhe në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA)), në datën 31.7.2025, konkurrentja Ornela Fitezi, duke e vlerësuar se i plotësonte kriteret e përgjithshme dhe posaçme të përcaktuara në shpalljen e pozicionit të lirë “*Drejtor, Drejtoria e Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale*”, Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, (INSTAT) kodi #248, ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e ngritjes në detyrë që do të zhvillohej për plotësimin e këtij pozicioni të lirë.

Duke analizuar informacionin e dërguar prej saj, rezulton se, kandidatja ka ngritur një pretendim në lidhje me përbërjen e Komitetit të Pranimi për Ngritjen në Detyrë (KPND), duke argumentuar se nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe kreut III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.3.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar.

Po kështu, kandidatja ngre pretendimin e parregullsive edhe në testimin me shkrim pasi pyetjet nuk ishin të balancuara dhe nuk reflektonin në mënyrë të drejtë kompetencat e nevojshme për pozicionin e shpallur.

Në këto kushte, duke mos qenë dakord me sa më sipër, kandidatja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e organeve të rekrutimit, gjatë zhvillimit të procedurës së ngritjes në detyrë.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me këtë informacion, në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka filluar kryesisht procesin e verifikimit paraprak të informacionit duke e njoftuar institucionin me shkresën nr. 797/1 prot., datë 19.9.2025, të Komisionerit, “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin paraprak të procedurës së konkurrimit për pozicionin “Drejtor”, Drejtoria e Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale, Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, pranë Institutit të Statistikave*” duke kërkuar dokumentacionin dhe aktet të cilat materializojnë veprimet e kryera për zhvillimin e procedurës në fjalë.

Në vijim të komunikimit, INSTAT, me shkresën nr. 1441/8 prot., datë 29.09.2025 “*Kthim përgjigje shkresës nr. 1441/7 prot., datë 22.09.2025*”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 797/4 prot., datë 01.10.2025, ka dërguar dokumentacionin e plotë të kërkuar.

Referuar përmbajtjes së dokumentacionit të administruar sa më sipër, si dhe analizës së pretendimeve të ngritura nga pjesëmarrësja në procedurën e konkurrimit në fjalë, rezulton se:

Njësia përgjegjëse e institucionit INSTAT, në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, ka shpallur procedurën e konkurrimit me kod #248, për plotësimin e pozicionit “*Drejtor, Drejtoria e Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale*”, Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, në portalin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, me shkresën nr. 1152 prot., datë 20.6.2025 dhe në faqen Web të institucionit.

Nga dokumentacioni i administruar, përsa i përket fazës së parë të rekrutimit, atë të lëvizjes paralele, duke vlerësuar aktet që verifikojnë procesin e verifikimit paraprak dhe atë përfundimtar të cilat janë dërguar nga INSTAT pranë Komisionerit, rezulton se nuk ka patur kandidatë të kualifikuar për të kaluar këtë fazë, e si rrjedhojë, në rastet kur një vend vakant në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse kalon në procedurën e ngritjes në detyrë.

Konkurrimi për procedurën e ngritjes në detyrë, referuar pikës 21 të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, përfshin dy faza:

- a) verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- b) vlerësimin e kandidatëve

Në këto kushte, njësia përgjegjëse e institucionit, në zbatim të pikës 6, të nenit 26, të ligjit 152/2013, si dhe referuar pikës “21/a”, pikës 22, të vendimit të mësipërm, ka bërë verifikimin paraprak, në përfundim të të cilit rezultojnë të kualifikuar për këtë fazë të konkurrimit dy aplikantë A. Berbiu dhe O Fitezi.

Nga verifikimi i dosjes së konkurimit rezultoi se për fazën e verifikimit paraprak nuk kishte ankesë dhe për këtë arsye, njësia përgjegjëse ka përfunduar verifikimin, duke publikuar listën e kandidatëve të kualifikuar si dhe duke njoftuar individualisht kandidatët (e-mail datës 22.6.2025) se testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 31.7.2025, ora 11.00, në ambjentet e INSTAT dhe intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet po në të njëjtën ditë (sipas aktit: “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit për ngritje në detyrë*”, në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese, kodi #248 “*Drejtor*”, Drejtoria e Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale, Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, kategoria II-1, bashkëlidhur dosjes së konkurimit).

Po duke ju referuar pikës 6, të nenit 26, të ligjit, dhe pikës “21/b” të aktit nënligjor të evidentuar më sipër, Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë që ngrihet nga njësia përgjegjëse, ka si detyrë vlerësimin e kandidatëve.

Në lidhje me pretendimin e aplikantes që ka të bëjë me përbërjen e Komitetit të Pranimit dhe Ngritjes në Detyrë (KPND), sqarojmë se, në pikën 7, të kreut III, të Vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* i ndryshuar, parashikohet se Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin;
- b) 1 (një) anëtar i zgjedhur nga titullari midis nëpunësve civilë të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;
- c) eprorin direkt të pozicionit, për të cilin zhvillohet konkurrimi;
- ç) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit.

Në zbatim të kësaj dispozite, me Urdhrin nr. 140, (nr. 1367 prot.), datë 28.7.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm, *“Për krijimin e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë për pozicionin: kodi # 248 “Drejtor”, Drejtoria e Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale”*, është ngritur Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë, i ndryshuar, me këtë përbërje:

- a) Znj. E. Dhuli, Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e eprorit direkt të pozicionit të shpallur;
- b) Z. D. Kristo, Drejtor në Drejtorinë e Komunikimit dhe Publikimeve (nëpunësi A. Xhikneli është zëvendësuar me shkresën nr.1367/1 prot., datë 31.7.2025 *“Për një ndryshim në urdhërin Nr.140, datë 28.7.2025”* me nëpunësin D. Kristo, Drejtor në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit), në cilësinë e nëpunësit të nivelit të mesëm drejtues;
- c) Znj. R. Koçi, Specialist në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në cilësinë e përfaqësuesit të njësisë përgjegjëse;
- d) Znj. M. Kasimati, në cilësinë e ekspertëve të fushës;
- e) Znj. N. Baci, në cilësinë e ekspertëve të fushës.

Konstatohet se në përbërje të KPND, në cilësinë e eprorit direkt, është vendosur Drejtori i Përgjithshëm dhe jo nëpunësi i emëruar në pozicionin *“Drejtor i Përgjithshëm”*, i Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit Statistikor, i cili është eprori direkt i pozicionit vakant të shpallur. Ndërkohë provohet se, ky veprim ka ndodhur në kushtet kur në datën 31.7.2025, ky zyrtar ka qenë me leje nga titullari, për një afat të pacaktuar, ç’ka përkon me ditën kur është hartuar urdhri për ngritjen e KPND, si edhe kjo situatë ka vijuar dhe më tej, përgjatë gjithë procedurës së konkurimit.

Në këto rrethana, ashtu sikurse është parashikuar në nenin 4, pika 1, germa i), të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunsin civil”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se, eprori direkt i Drejtorit të Përgjithshëm është titullari i institucionit, është kryer edhe zëvendësimi me këtë zyrtar në aktin administrativ për ngritjen e KPND.

Sa i takon pretendimit tjetër të ngritur nga kandidatja O. Fitezi, që ka lidhje me hartimin e pyetjeve në testimin me shkrim, për këtë procedurë konkurimi, konstatohet se:

Sipas bazës ligjore që rregullon këtë institut të ligjit, Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND) si një organ kolegjal (*referuar pikës 2, V/3, të udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të DAP*), në zbatim të pikës 29, të kreut III, të Vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, 24 orë, përpara fillimit të fazës së vlerësimit të kandidatëve, zgjedh një grup pyetjesh për testimin e fushës së njohurive, të aftësive e të cilësive të shpallura në shpalljen për konkurim, e njejta gjë vlen më pas edhe për fazën e intervistës së strukturuar me gojë, pra është në diskrecion të këtij organi kolegjal përcaktimi i pyetjeve në çdo procedurë konkurimi.

Nga analiza e dokumentacionit, pjesë përbërëse e dosjes së konkurimit, konstatohet se pyetjet e testimit me shkrim janë hartuar brenda fushës së legjislacionit të përcaktuar në shpallje, me alternativa (10 pyetje) dhe shtjellim (3 pyetje të tjera).

Më tej është kaluar në intervistën e strukturuar me gojë, ku të gjithë anëtarët prezent të KPND, kanë plotësuar deklaratën e paanshmërisë, dhe asnjëri prej tyre nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me aplikantët pjesëmarrës (*deklaratat e nëshkruara në datën 31.7.2025, janë pjesë përbërëse e dosjes së konkurimit*).

Përpara zhvillimit të intervistës, në respektim të pikës 5, Kreu V, të udhëzimit të DAP, kandidatja është njoftuar nëse pranon që intervista të regjistrohet me zë. Verifikohet që kandidatja ka dhënë pëlqimin që intervista të mos regjistrohet, duke nënshkruar edhe deklaratën përkatëse, e në këto kushte çdo pretendim i ngritur në lidhje me këtë fazë të konkurimit është i pamundur të verifikohet nga ana e Komisionerit.

Pas përfundimit të intervistës së strukturuar me gojë, KPND ka renditur kandidatët dhe ka njoftuar njësisë përgjegjëse, e cila në respektim të pikës 34 (*brenda 24 orëve*), ka njoftuar individualisht kandidatët për rezultatin e konkurimit (*njoftimi me e-mail-in e datës 7.8.2025*).

Duke mos qenë dakord me procedurën e konkurimit, kandidatja O. Fitezi, është ankuar pranë KPND, duke kërkuar anullim të procedurës së konkurimit dhe ka marrë përgjigje për ankesën e saj në datën 3.9.2025, me procesverbalin e mbajtur nga KPND në datën 29.8.2025. Ndërkohë, konstatohet se, në datën 3.10.2025, nëpunësja O. Fitezi, i është

drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të njëjtin objekt.

Mbështetur në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk është e nevojshme të vijojë më tej hetimi administrativ, në lidhje me këtë procedurë, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, duke rregulluar dhe pasojat e saj.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; të nenit 36, të ligjit nr. 8116, dt. 29.3.1996 “*Kodi i Procedurës Civile*”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e informacionit të regjistruar me shkresat me shkresat nr. 797, datë 9.9.2025; nr. 797/2 prot., datë 24.9.2025; nr.797/3 prot., datë 1.10.2025; dhe nr. 797/5 prot., datë 1.10.2025, dërguar nga nëpunësja Ornela Fitezi, pasi mosmarrëveshja është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe do të zgjidhet në themel nga gjykata kompetente.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Institutit të Statistikave, si dhe nëpunësja Ornela Fitezi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha